



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 074/22
Data 16.09.2022

Prishtinë, 07 shkurt 2022
Kodi i ZRRE-së: V_1486_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenin 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenin 47 dhe Nenin 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Rregullën ZRRE/Nr.15/2017 për vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU-së);
- Dispozitat ligjore të Rregullës ZRRE/Nr.03/2017 për vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit, Transmetimit dhe Tregut (Rregulla për të Hyrat e OST/OT-së);
- Dispozitat ligjore të Rregullës ZRRE/Nr.05/2017 për vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për të Hyrat e OSSH-së);
- Njoftimin e ZRRE Nr. 643/21 të datës 13.12.2021 për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për operatorët e rregulluar;
- Aplikacionin e operatorit të licencuar si Furnizues me Shërbim Universal të energjisë elektrike (FSHU/KESCO SH.A) për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal, të dorëzuar më datën 28 dhjetor 2021 në ZRRE;
- Vendimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut OST/OT, Nr. V_1484_2022;
- Vendimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes – OSSH, Nr. V_1485_2022;

në seancën e mbajtur më 07 shkurt 2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (HLM)** për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU), që do të mblidhen nga FSHU përmes tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, nga data 09.02.2022 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit me Shërbim Universal, që mbulohen nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për vitin relevant tarifor 2022, do të jenë në vlerë prej 347,282,520 Euro.



- III. FSHU sipas këtij Vendimi udhëzohet të përgatisë dhe të dorëzojë në ZRRE propozimin për aprovim të tarifave të rregulluara me pakicë sipas këtij Vendimi.
- IV. Tarifat e propozuara nga i licencuari FSHU duhet të jenë në përputhje me parimet e vendosura në Rregullën ZRRE/Nr.15/2017 për Vendosjen e të Hyrave për FSHU.
- V. Ky vendim do të zbatohet nga FSHU nga data 09 shkurt 2022 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

ARSYETIM

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 13 dhjetor 2021 ka iniciuar Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara Maksimale për operatorët e Rregulluar, duke përfshirë edhe Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU);
- o ZRRE sipas njoftimit të saj, ka vlerësuar se ekzistojnë argumente të qarta dhe në bashkërendim me procesin e fundit tarifor, ka konstatuar se ka indikacione të tejkalimit të pragut të materialitetit prej 5 % në të Hyrat e Lejuara Maksimale të operatorëve të rregulluar të energjisë elektrike.
- o ZRRE në vazhdimësi ka monitoruar situatën e furnizimit me energji elektrike dhe nga analizat e bëra, ka konstatuar se si pasojë e mbizotërimit të çmimeve të larta të energjisë elektrike në bursat ndërkombëtare, është rrezikuar siguria e furnizimit për konsumatorët fundorë me energji elektrike. Duke qenë se kostot e blerjes së energjisë me shumicë janë jashtë kontrollit të operatorëve, konform kornizës ligjore të rregullimit, ZRRE ka iniciuar shqyrtim të jashtëzakonshëm të HLM për operatorët e rregulluar, me qëllim të ruajtjes së sigurisë së furnizimit për konsumatorët e energjisë elektrike dhe reflektimit të kostove të furnizimit.
- o Prandaj, mbështetur në kornizën ligjore në fuqi, ka hapur shqyrtimin e jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU).
- o ZRRE me datë 23 dhjetor 2021 nga Operatorit Sistemit të Transmëtitimit dhe Tregut (OST/OT) ka pranuar aplikacionin për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut.
- o ZRRE me datë 28 dhjetor 2021 nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) ka pranuar aplikacionin për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes.
- o ZRRE me datë 28 dhjetor 2021 nga Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU) ka pranuar aplikacionin për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal.
- o ZRRE më datë 17 janar 2022 ka publikuar Raportin Konsultativ - Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm i të Hyrave të Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike për Operatorët e Rregulluar.
- o Raporti Konsultativ ka paraqitur qëndrimet e ZRRE-së, për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të HLM, për të mbuluar ndryshimin e ndjeshëm në kostot e blerjes së energjisë elektrike dhe për të rivendosur furnizimin me energji elektrike për konsumatorët, si dhe raporti është publikuar krahas



një raporti tjetër konsultativ që synon të marrë qëndrimet e palëve të interesit për propozimet e ZRRE-së, për ndryshimin e strukturës tarifore për të rritur eficiencën e konsumit të energjisë elektrike.

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 17 janar 2022 ka publikuar Raportin Konsultativ-Shqyrtimi i Strukturës Tarifore për Konsumatorët e Rregulluar të Amvisërive të shërbyer nën FSHU.
 - Raporti konsultativ ka paraqitur qëndrimet e ZRRE-së për ristrukturimin e nevojshëm të tarifave për të përmbushur kostot e blerjes së energjisë elektrike dhe për të rivendosur furnizimin me energji elektrike për konsumatorët. Ndër tjera, ZRRE ka shqyrtuar shkallën në të cilën struktura aktuale e tarifave ka çuar në një rritje joefikase të kërkesës për energji elektrike dhe ka propozuar strukturën tarifore alternative e cila inkurajon konsumin optimal të energjisë elektrike.
 - ZRRE ka pranuar komente nga palët e interesit, duke përfshirë operatorët e rregulluar të sektorit të energjisë elektrike, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, konsumatorët individual, Zyrën e Presidentes së Republikës së Kosovës, INDEP, Balkan Green Foundation – BGF, Shoqatën e Mullisëve të Kosovës, Komentet e LDK-së, GP LVV, Komentet e AAK-së, Ministrinë e Ekonomisë, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Kërkesën nga Komuna e Obiliqit.
 - Në vlerësimin përfundimtar të HLM për FSHU, ZRRE ka marrë për bazë edhe alokimin e subvencionit shtesë prej 10 milion euro sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.05/55 të datës 21.01.2022, si dhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për subvencionim prej 90 milion euro shtesë sipas vendimit Nr.01/60 i datës 05.02.2022.
 - ZRRE gjatë shqyrtimit publik i ka trajtuar të gjitha komentet e palëve të interesit, dhe të gjithë atyre që kanë dërguar komente në ZRRE, të cilat i ka përfshirë në Raportin përfundimtar për të Hyrat e Lejuar Maksimale për operatorët e Rregulluar dhe strukturën tarifore për FSHU.
 - Raporti përfundimtar i Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për operatorët e rregulluar dhe Struktura Tarifore për konsumatorët e rregulluar të amvisërisë të shërbyer nën FSHU, përfshinë vlerësimet përfundimtare dhe përgjigjet në komente të palëve të interesit.
 - Bordi i ZRRE pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- VI. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.


Borësi ZRRE-së:



Ymer Fejzullahu, kryesues




Selman Hoti, anëtar



Izet Rushiti, anëtar



Lutfije Dervishi, anëtar



Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO,
- KEDS,
- KOSTT dhe
- Arkivit të ZRRE-së.